

20230571079

Në bazë të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), nenit 68, paragrafi 1, pika 2 dhe nenit 69, paragrafi 2 të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16, 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19 dhe 122/21) dhe pikat 2 dhe 3 të Vendimit për përcaktimin e renditjes pas së cilës zëvendësguvernatorët do ta zëvendësojnë guvernatorin gjatë mungesës së tij nga puna ose pamundësisë të kryej detyrat e punës gjatë vitit 2023 nr. 04-43353/1 nga 30 dhjetori 2022, Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mori

VENDIM PËR METODOLOGJINË E MENAXHIMIT TË RREZIKUT TË KREDISË

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përshkruhet metodologjia e menaxhimit të rrezikut të kredisë, përfshirë edhe vërtetimin e kriterëve të klasifikimit të normave aktive të bilancit dhe jashtë bilancit sipas shkallës së rrezikut dhe mënyrës së përcaktimit të përmirësimit të vlerës dhe rezervës së posaçme, pra humbjen e pritshme kreditore për ekspozimet kreditore.

Metodologjia e menaxhimit të rrezikut të kredisë sipas paragrafit 1 të kësaj pike i përfshin edhe standardet mbikëqyrëse të lidhura me mënyrën e kreditimit dhe procedurës së rregullimit të kërkesave të arritura për pagesë, të cilat janë të papaguara, mënyrën e përcaktimit të ekspozimit të ristrukturuar dhe me probleme të rrezikut të kredisë dhe mënyrës së kryerjes së shlyerjes dhe shitjes së kërkesave të vonuara, me probleme dhe të fshira nga marrëveshja për kredi.

2. Disa shprehje të përdorura në këtë vendim e kanë këtë kuptim:

2.1. Me "rrezik të kredisë" nënkuptohet rreziku nga humbja për bankën, shkaku i pamundësisë së klientit t'i shlyej detyrimet ndaj saj, në shumën e kontraktuar dhe/ose në afatet e kontraktuara.

2.2. "Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë" ose "ekspozimi kreditor" i përfshin:

- pozicionet e bilancit të cilat janë në pajtim me Rregulloren e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për metodologjinë e evidentimit dhe vlerësimit të normave të kontabilitetit dhe të përgatitjes së raporteve financiare trajtohen si mjete financiare të cilat maten sipas vlerës së amortizuar të blerjes dhe mjeteve financiare të cilat maten sipas vlerës objektive përmes të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, siç janë kreditë; depozitat, investimet në instrumente të borxhit; kërkesa në bazë të kontratave për lizing; kërkesat e shlyera (faktoring dhe forfitng); pagesat e kryera në bazë të garancive, akreditivave, dhe pozitave tjera jashtë bilancit të të dhënave; interesave, provizioneve dhe tarifave, kërkesat në bazë të marrëveshjeve tregtare dhe të tjera me klientët dhe mjetet tjera financiare të cilat e ekspozojnë bankën në rrezik të kredisë;

- pozitat jashtë bilancit në bazë të detyrimeve të marra kreditore (kreditë kornizë të parevokueshme të papërdorura, mbitërheqjet e papërdorura xhirollogaritë dhe kartelat kreditore); detyrimet e parevokueshme të ndërmarra të paplotësuara për shlyerjen e kërkesave; garancitë e dhëna të pambuluara; akreditivat e hapura të pambuluara; garancitë e dhëna; pranimet e dhëna dhe pozicionet tjera jashtë bilancit të cilat paraqesin detyrim të mundshëm për bankën, me përjashtim të detyrimeve të ndërmarra jashtë bilancit për kredi të cilat në pajtim me Rregulloren e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit trajtohen si kërkesa jashtë bilancit me rrezik të ulët.

Pozitat në vijim nuk janë pjesë e ekspozimit kreditor:

- mjetet monetare, ari dhe metalet tjera të çmuara, mjetet e llogarive të bankës te Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, investimet në filiale, shoqëritë e lidhura dhe në funksionim të përbashkët, mjetet jomateriale, tokën, patundshmëritë dhe pajisjet, pasuritë natyrore, mjetet e ndërmarra në bazë të kërkesave të pashlyera, mjetet e punës dhe rezervat;

- mjetet financiare të cilat e ekspozojnë bankën në rrezik të tregut dhe/ose tjetër lloj të rrezikut, të ndryshëm nga rreziku kreditor: investimet në instrumentet e pronësisë, investimet në instrumentet e borxhit të cilat maten sipas vlerës objektive përmes bilancit të suksesit dhe kredive dhe kërkesave të cilat maten sipas vlerës objektive përmes bilancit të suksesit.

2.3. Me "klient" nënkuptohet person ndaj të cilit është vendosur ekspozim kreditor.

2.4. Me "afat të maturimit" nënkuptohet dita në të cilën klienti ka qenë i detyruar të paguajë një shumë të caktuar të parave, në pajtim me marrëveshjen e bërë me bankën.

2.5. Me "të arritura për pagesë, por të papaguara" ose "kërkesa të maturuara" nënkuptohet shuma e kërkesës së bankave mbi bazën kryesore, interesin dhe kërkesat tjera të cilat klienti është i detyruar ti paguan në afatin e maturimit, si dhe kërkesat e bankës për pagesat e kryera në bazë të garancisë, akreditivit ose ndonjë lloji tjetër të pozitës jashtë bilancit sipas nënpikës 2.2, nënparagrafi 2 të kësaj pike.

2.6. Me "rritje të rrezikut të kredisë" nënkuptohet përkeqësimi i cilësisë së kredisë (rritje të rrezikut të kredisë), i përcaktuar në pajtim me Rregulloren e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për metodologjinë e evidentimit dhe vlerësimit të normave të kontabilitetit dhe për përgatitjen e raporteve financiare.

2.7. Me "ekspozim kreditor në bazë të financimit të projekteve" ose "financimit projektues" nënkuptohet ekspozimi kreditor për të cilin banka do ta paguajë nga rrjedhat monetare të krijuara nga projekti dhe e cila mund të sigurohet me projektin të cilin financohet (për shembull: Termocentralet, infrastruktura transportuese dhe telekomunikuese, xeheroret, ndërtesat banuese dhe/ose afariste, depot, hotelet, hekurudhat etj.).

2.8. Me "ekspozim të përbashkët kreditor" (ang. Joint credit obligations) nënkupton shumën totale të ekspozimit ndaj dy ose më shumë klientëve

(bashkëkreditorët) të cilët janë po aq përgjegjës për kryerjen e detyrimeve të cilat vijnë nga ekspozimi i përbashkët kreditor i miratuar nga banka.

2.9. Me "instrumente të njohura të kolaterale" llogariten instrumentet kolaterale sipas pikës 25 të këtij vendimi të cilat përfshihen në llogaritjen e vlerës së tashme të rrjedhave monetare të pritura të ekspozimeve kreditore për përcaktim të përmirësimit të vlerës.

2.10. Me "instrument i klasit të parë kolateral" llogariten instrumentet kolaterale sipas pikës 26 të këtij vendimi.

2.11. Me "portofol të kredive" nënkupthet ekspozimet kreditore të cilat mund të jenë të grupuara sipas afinitetit të karakteristikave të tyre dhe të rrezikut të kredisë, në pajtim me pikën 28 të këtij vendimi.

2.12. Me "humbje të pritshme kreditore" nënkupthet humbja e pritshme kreditore e nën pikës 2.13. të kësaj pike ose humbjen e pritshme kreditore të bazës së grupit sipas nën pikës 2.14. të kësaj pike.

2.13. Me "humbje të pritshme kreditore në bazë individuale" nënkupthet dallimi mes vlerës së kontabilitetit të ekspozimit kreditor dhe vlerës momentale të rrjedhave monetare të pritshme nga ai ekspozim kreditor.

2.14. Me "humbje të pritshme në bazë grupore" nënkupthet prodhimi i normës së probabilitetit të mospagesës, normës së humbjes shkaku i mospagesës dhe shumës së ekspozimit kreditor e cila është pjesë e portofolit të kredisë.

2.15. Me "normë të probabilitetit të mospagesës" nënkupthet norma e probabilitetit të mospagesës për 12 muaj ose norma e probabilitetit të mospagesës gjatë gjithë jetëgjatësisë.

2.16. Me "normë të probabilitetit të mospagesës për 12 muaj" (ang. 12 month probability of default) nënkupthet probabiliteti se ekspozimi kreditor nga portofoli i kredive do të jetë jofunksionale në afat prej dymbëdhjetë muajve nga data e përcaktimit të normës.

2.17. Me "normë të probabilitetit të mospagesës gjatë gjithë jetëgjatësisë" (ang. life time probability of default) nënkupthet probabiliteti se ekspozimi kreditor nga portofoli i kredive do të jetë jofunksional gjatë gjithë jetëgjatësisë, pra deri në afatin e maturimit.

2.18. Me "normë të humbjes shkaku mospagimit" (ang. loss given default) nënkupthet pjesa nga kreditë me probleme ose ekspozimet kreditore të shlyera të cilat banka nuk mund ti paguaj.

2.19. Me "ristrukturim të ekspozimit kreditor" ose "ristrukturim" nënkupthet ndryshim të kushteve kontraktuale të ekspozimit kreditor ekzistues ose miratimin e një ekspozimi të ri kreditor për mbylljen e ekspozimit kreditor ekzistues të klientit, i cili ka vështirësi financiare për të shlyer detyrimet e tij, ku ndryshimi, ose miratimi i një ekspozimi të ri kreditor nuk do të realizohej nëse klienti mundet ose do të mundet ti respektojë kushtet nga kontrata aktuale e ekspozimit kreditor (më tutje në tekst: kushtet kontraktuale ekzistuese).

2.20. Me "ekspozim i ristrukturuar i kredisë" nënkupthet ekspozimi kreditor i cili është subjekt i ristrukturimit:

2.21. Me "ekspozim të ristrukturuar të kredisë me ndryshim të konsiderueshëm të kushteve kontraktuale" (ang. Distressed restructuring) nënkuptohet ndryshimi i kushteve kontraktuale të ekspozimit kreditor ekzistues ndaj klientit i cili ballafaqohet me vështirësi serioze financiare, për çka bëhet ulje e konsiderueshme e detyrimeve të tij (ang. Diminish financial obligation) ndaj bankës, duke pasur parasysh dispozitat sipas pikës 56 të këtij vendimi.

2.22. Me "periudhë prove" nënkuptohet periudha prej dy viteve nga data e ristrukturimit ose nga data kur janë plotësuar kushtet e përjashtimit të ekspozimit kreditor nga kategoria e ekspozimit të ristrukturuar kreditor me probleme, në pajtim me pikën 60 të këtij vendimi.

2.23. Me "ekspozim kreditor të papaguar" nënkuptohet ekspozimi kreditor i bankës ndaj klientit i cili plotëson cilin do nga këto kushte:

- shuma e kërkesave të maturuara ndaj klientit pas çdo lloj baze (shuma kryesore, interesi dhe kërkesa tjera pa interes) nuk është paguar më gjatë se 90 ditë të njëpasnjëshme llogaritur nga dita e shumës së arritur, e ka tejkaluar pragun e rëndësisë sipas nënpikës 2.24. të kësaj pike (më tutje në tekst: tejkalimin e pragut të rëndësisë);
- është vërtetuar se klienti nuk mund t'i shlyej detyrimet e tij ndaj bankës në tërësi, pa u ndërmarrë aktivitete për pagesë të ekspozimit nëpërmjet aktivimit të sigurimit (më tutje në tekst: pamundësi pagese).

Me përjashtim të paragrafit 1, nënparagrafit 1 të kësaj nënpike, për ekspozimet ndaj personave fizikë, banka mund të përcaktojë ekspozim kreditor të papaguar në nivel të ekspozimit individual kreditor, nëse ajo është e paraparë në aktet e saj të brendshme, duke pasur parasysh dispozitat sipas pikës 48 dhe pikës 62, nënpika 62.2. të këtij vendimi.

2.24. Me "prag të rëndësisë" nënkuptojmë plotësimet e komponentit absolut dhe relativ të nënpikave 2.25. dhe 2.26. të kësaj pike. Llogaritet se pragu i rëndësisë është tejkaluar nëse tejkalohen dy komponentët e pragut të rëndësisë.

2.25. Me "komponent absolut" nënkuptohet shuma totale e të gjitha kërkesave të maturuara. Komponenti absolut është i barabartë me:

- 6.000 denarë, ose shumë përkatëse të kundërvlerës në valutë tjetër, për klientët persona fizikë,
- 30.000 denarë, ose shumë përkatëse të kundërvlerës në valutë tjetër, për klientët persona fizikë (përfshirë edhe shoqëritë e vogla).

2.26. Me "komponent relativ" nënkuptohet raporti (i shfaqur në përqindje) mes shumës totale të të gjitha kërkesave të maturuara dhe shumës totale të të gjitha ekspozimeve të bilancit të bankës ndaj klientit në bruto-shumë, pra pa u marrë parasysh shuma e përmirësimit të vlerës dhe amortizimit të akumuluar. Komponenti relativ është i barabartë me 1%.

2.27. Me "ekspozim kreditor me probleme" nënkuptohet:

- ekspozim kreditor i papaguar sipas nënpikës 2.23. të kësaj pike;
- ekspozimi tek i cili është përcaktuar se ekzistojnë dëshmi objektive se ka ndodhur dëm, në pajtim me Rregulloren e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për metodologjinë e evidentimit dhe vlerësimit të normave kontabiliste dhe për përgatitje të raporteve financiare;
- ekspozimi kreditor i klasifikuar në kategoritë e rrezikut "Ç" dhe "D";

- ekspozimi kreditor i cili i plotëson kushtet e pikës 58 të këtij vendimi;
- pozita jashtë bilancit sipas nënpikës 2.2., paragrafi 1, nënparagrafi 2 të kësaj pike, për të cilën ekziston mundësia se do të aktivizohet ose përdoret me çka ekspozimi i bilancit i cili do të krijohet me aktivimin ose përdorimin e tij do t'i plotësojë kushtet e ekspozimit kreditor me probleme, në pajtim me këtë nënpikë.

2.28. Me "normën e kredive me probleme" nënkuptohet raporti mes shumës totale të kredive (shumës kryesore) me probleme dhe shumës totale të kredive (shumës kryesore) të bankës, në bruto-shumë, pra pa u marrë parasysh shuma e përmirësimit të vlerës / rezervës së posaçme dhe amortizimit të akumuluar.

2.29. Me "normë të ekspozimeve kreditore me probleme" nënkuptohet raporti mes shumës totale të ekspozimeve kreditore me probleme dhe ekspozimi kreditor total i bankës, në brutoshumë, pra pa u marrë parasysh shuma e përmirësimit të vlerës / rezervën e posaçme dhe amortizimin e akumuluar.

2.30. Me "shitjen e ekspozimit kreditor me humbje të konsiderueshme" nënkuptohet shitja e ekspozimit kreditor gjatë së cilës është realizuar humbje e konsiderueshme, e përcaktuar në pajtim me pikën 55 të këtij vendimi.

2.31. Me "eksportues-neto" nënkuptohet rezidenti i cili në dymbëdhjetë muajt e fundit ka realizuar të ardhura më të mëdha valutore në bazë të eksportit të realizuar, nga të dalat valutore në bazë të importit të realizuar.

2.32. Me "tregues DSTI" (ang. debt service-to-income) nënkuptohet raporti mes shumës së detyrimeve totale të personit fizik në bazë të ekspozimeve kreditore të të gjitha bankave dhe kursimoreve ndaj atij personi dhe të detyrimeve totale të personit ndaj institucioneve financiare tjera në bazë mujore dhe të ardhurat totale të atij personi, në bazë mujore.

2.33. Me "tregues TDTI" (ang. debt-to-income) nënkuptohet raporti mes shumës së detyrimeve totale të personit fizik në bazë të ekspozimeve të të gjitha bankave ndaj atij personi dhe të detyrimeve totale të personit ndaj institucioneve tjera financiare dhe të ardhurave totale të cilat personi i realizon në nivel vjetor.

2.34. Me "tregues LTV" (ang. loan-to-value) nënkuptohet raporti mes shumës së ekspozimit kreditor ndaj personit fizik dhe vlerës së patundshmërisë ndaj të cilës është vendosur hipotekë për sigurim të atij ekspozimi kreditor.

2.35. Me "kredi të gjelbër" (ang. green finance) nënkuptohet ekspozimi kreditor i cili përdoret për përmirësimin e efikasitetit energjetik të amvisërive dhe sektorit i korporatave, për mbështetje të investimeve në teknologji të gjelbra, materiale dhe të ngjashme, për mbështetje të investimeve në burime ripërtëritëse të energjisë, si dhe për kontroll dhe/ose parandalim të ndotjes së ajrit, mbrojtje të mjedisit jetësor, uljen e rreziqeve lidhur me ndryshimet klimatike dhe të ngjashme.

3. Për gjithçka që nuk është definuar me këtë vendim, përkatësisht zbatohet kuptimi i termeve të përcaktuara me Ligjin e Bankave dhe me aktet nënligjore të miratuara me këtë ligj.

4. Banka kryen klasifikim të ekspozimeve kreditore me zbatimin e dispozitave sipas kreut 0 të këtij vendimi dhe përcakton përmirësim të vlerës dhe rezervës së posaçme,

pra të humbjes së pritshme kreditore të ekspozimeve kreditore me zbatimin e dispozitave sipas kreut 0 të këtij vendimi.

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (më tutje në tekst: Banka Popullore) e kontrollon klasifikimin e klientit të kryer nga ana e bankës, si dhe modelin e përcaktimit të humbjes së pritshme të humbjes në bazë grupore dhe mund ta udhëzojë bankën të bëjë ndryshime të kategorisë së rrezikut dhe/ose modelit të përcaktimit të humbjes së pritshme të kredisë në bazë grupore, pra të shumës së humbjes së pritshme kreditore.

Banka është e detyruar, sapo të pranojë dokument përkatës nga Banka Popullore (shkresë, vendim, procesverbal ose ndonjë dokument tjetër), t'i zbatojë ndryshimet sipas paragrafit 2 të kësaj pike.

II. KLASIFIKIMI I EKSPOZIMIT KREDITOR

Kërkesa të përgjithshme

5. Banka është e obliguar të kryej klasifikim të ekspozimit kreditor në bazë të kontratës individuale të kategorive të rrezikut sipas pikës 9 të këtij vendimi, së paku në bazë mujore, me gjendjen e fundit të muajit.

6. Gjatë klasifikimit të ekspozimit kreditor gjatë miratimit të saj, banka i merr parasysh: - aftësia kreditore e klientit, pra cilësia e projektit, në pajtim me pikën 7 të këtij vendimi dhe - rregullsia e shlyerjes së detyrimeve, në pajtim me pikën 8 të këtij vendimi.

Gjatë çdo klasifikimi të mëtejshëm të ekspozimit kreditor, banka i merr parasysh:

- ndryshimet në aftësinë kreditore të klientit, pra të cilësisë së projektit, në pajtim me pikën 7 të këtij vendimi dhe
- rregullsia e shlyerjes së detyrimeve, në pajtim me pikën 8 të këtij vendimi.

7. Aftësia kreditore e klientit, pra ndryshimi i aftësisë së tij kreditore vlerësohet duke zbatuar të paktën kriteret e mëposhtme

- karakterin e klientit, pra veçoritë e tij statusore dhe ekonomike dhe cilësinë dhe ekspertizën e organeve udhëheqëse dhe të mbikëqyrjes;
- nëse përdorimi i mjeteve është në pajtim me qëllimin e rënë dakord të ekspozimit kreditor;
- nëse përdorimi i mjeteve të ekspozimit kreditor do të shkaktojë të ardhura të parave të gatshme të klientit në vëllimin dhe dinamikën të cilat përshtaten në mënyrën e dakorduar të pagesës së detyrimeve;
- shumën e kapitalit, rezervave dhe gjendja pasurore e klientit, të ardhurat monetare të realizuara të klientit, si dhe aftësia e realizimit të të ardhurave në të ardhmen;
- perspektivën e klientit dhe e veprimtarisë së cilës i takon ai;
- pozitën likuiditetit dhe profitabilitetit të klientit;
- ndikimet e mundshme nga personat e lidhur me klientin ndaj aftësisë së tij kreditore;
- treguesit makroekonomik ose treguesit tjerë të cilët mund të kenë ndikim mbi nivelin e rrezikut të kredisë (për shembull: shkalla e papunësisë, çmimet e patundshmërive, çmimin e

produktit të cilin klienti e prodhon ose shërbimi të cilin e jep dhe të ngjashme); - gjendjen politike dhe ekonomike e vendit ku gjendet selia e klientit;

- nivelin e borxhit të klientit;
- mënyrën e shlyerjes së detyrimeve në bazë të kredive dhe formave tjera të ekspozimit kreditor ndaj bankës, bankave të tjera, detyrimeve ndaj personave tjerë fizikë ose juridikë dhe të ngjashme, të përcaktuara në bazë të burimeve të brendshme dhe/ose të jashtme (për shembull:

Regjistri kreditor i Bankës Popullore, zyrat kreditore dhe të ngjashme);

- rejtingun kreditor të klientit, nëse ai ka një rejting të tillë;
- kategorinë e brendshme të rrezikut, nëse banka ka zhvilluar kategori të brendshme të rrezikut;

- ekspozimin e klientit ndaj rrezikut valutor, rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit dhe rreziqe tjera, nga aspekti i ndikimit të cilin e kanë këto rreziqe ose do të kishin mbi mundësinë që klienti t'i shlyej detyrimet ndaj bankës në pajtim me kushtet kontraktuale, në kushte të ndryshimit të kursit valutor, normës së interesit dhe ndryshime tjera që do të shkaktonin rritjen e ekspozimit kreditor të klientit. Gjatë vlerësimit të rrezikut valutor merren parasysh dispozitat sipas pikës 81 të këtij vendimi.

Gjatë vlerësimit të cilësisë së projektit, pra të ndryshimit të cilësisë së projektit për të cilin është kërkuar mbështetja financiare, banka i ka parasysh kriteret e paragrafit 1 të kësaj pike të cilat mund të zbatohen gjatë vlerësimit të cilësisë së projektit, duke i përfshirë këto kritere:

- kapacitetin financiar të projektit, i përcaktuar së paku në bazë të kornizës financiare të projektit dhe treguesit përkatës financiar;

- mënyrën e realizimit të projektit, i përcaktuar së paku në bazë të: marrëveshjeve të realizimit (ndërtimit) të projektit, probabilitetit dhe garancive për kryerje në kohë të projektit dhe lokacionit të projektit;

- përvojën e mëparshme dhe kapaciteti financiar i realizuesit në realizimin e projekteve të ngjashme;

- kapacitetin financiar të klientit, rëndësinë e projektit për klientin dhe përvojën e mëparshme me projekte të ngjashme;

- mbështetjen financiare të projektit nëpërmjet pjesëmarrjes personale nga ana e klientit;

- mjedisin ligjor, të përcaktuar së paku në bazë të kornizës ligjore dhe kohës së nevojshme për sigurim të dokumentacionit dhe lejeve të nevojshme.

Gjatë vlerësimit të aftësisë kreditore dhe ndryshimit të aftësisë kreditore të klientit person fizik, duhet të kenë parasysh kriteret sipas paragrafit 1 i kësaj pike të cilat përgjigjen karakteristikave të personave fizik.

Vlerësimi i ndryshimit të aftësisë kreditore të klientit, pra në cilësinë e projektit bëhet:

- së paku një herë në gjashtë muaj;

- Më shpesh se gjashtë muaj nëse plotësohen kriteret për rritjen e rrezikut të kredisë, të përcaktuara në aktet e brendshme në pajtim me pikën 78, nën pikën 78.4., të këtij vendimi; - gjatë ndryshimit të kushteve kontraktuale.

Me përjashtim të paragrafit 4 të kësaj pike, vlerësimi i ndryshimit të aftësisë kreditore të klientit bëhet së paku gjatë ndryshimit të kushteve kontraktuale.

Me përjashtim të paragrafit 4, nënparagrafit 1 të kësaj pike, vlerësimi i ndryshimit të aftësisë kreditore të klientit mund të bëhet së paku në bazë vjetore, nëse ekspozimi kreditor total i bankës ndaj atij personi nuk tejkalon 6.000.000 denarë.

8. Gjatë përcaktimit të rregullshmërisë së shlyerjes së detyrimeve, banka i merr parasysh:

- ditët e vonesës në shlyerjen e ekspozimit kreditor, për muajin për të cilin bëhet klasifikimi i ekspozimit kreditor (më tutje në tekst: ditët aktuale të vonesës) dhe
- ditët e vonesës së shlyerjes së ekspozimit kreditor gjatë periudhës së kaluar prej së paku gjashtë muajve.

Për nevojat e këtij vendimi, periudha e kaluar prej gjashtë muajve nuk e përfshin muajin për të cilin bëhet klasifikimi i ekspozimit kreditor.

Kategoritë e rrezikut

9. Banka bën klasifikim të këtyre kategorive të rrezikut:

9.1. Në kategorinë e rrezikut "A" klasifikohen:

- kërkesat nga Banka Qendrore Europiane, si dhe nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore të vendeve për të cilat janë në pajtim me Rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e përcaktimit të përshtatjes së kapitalit zbatohet në ponder të rrezikut prej 0%;
- ekspozimi kreditor ndaj klientit të cili gjendja financiare dhe rrjedhat financiare mundësojnë funksionim të papenguar dhe mundësi të shlyerjes së detyrimeve aktuale dhe të ardhshme ndaj bankës;
- ekspozimi kreditor për të cilin nuk është përcaktuar se ka ndodhur rritje e ekspozimit kreditor, në pajtim me pikën 0, nën pikën 0 të këtij vendimi;
- ekspozimi kreditor detyrimet e së cilit në datën e klasifikimit realizohen në pajtim me kushtet kontraktuale, pra ditët aktuale të vonesës nuk tej kalojnë 31 ditë;
- ekspozimi kreditor detyrimet e së cilit në periudhën e kaluar prej gjashtë muajve realizohen në pajtim me kushtet kontraktuale, me vonesë e cila nuk tejkalon 31 ditë ose me përjashtim deri në 60 ditë, nëse vonesë është më shumti dy herë në intervalin prej 32 deri 60 ditë;
- pjesa e ekspozimit kreditor e cila është e siguruar me instrumente kolaterale të klasit të parë, të përkufizuara në pikën 26 të këtij vendimi, nëse instrumenti aktivizohet në afat prej 90 ditëve nga afati i maturimit të ekspozimit kreditor;
- ekspozimi kreditor i cili gjendet në vitin e fundit të periudhës provë.

Me përjashtim të paragrafit 1, nënparagrafi 4 të kësaj nënpike, banka në kategorinë e rrezikut "A" mund ta klasifikojë ekspozimin kreditor me ditë aktuale të vonesës të cilat tej kalojnë 31 ditë, nëse shuma totale e papaguar më gjatë se 31 ditë është më e vogël se 1.000 denarë dhe se vonesa nuk është më e gjatë se 60 ditë.

9.2. Në kategorinë e rrezikut "B" klasifikohen:

- ekspozimi kreditor ndaj klientit / projektit i cili ka dobësi financiare, por gjendja financiare mundëson funksionimin e tij të papenguar;
- ekspozimi kreditor me ditë aktuale të vonesës të cilat nuk tej kalojnë 60 ditë;

- ekspozimi kreditor detyrimet e së cilit në periudhën e kaluar prej gjashtë muajve realizohen me vonesë e cila nuk tejkalon 60 ditë ose me përjashtim deri në 90 ditë, nëse vonesa është më shumë se dy herë në intervalin prej 61 deri 90 ditë;

- ekspozimi kreditor i cili trajtohet si ekspozim kreditor i ristrukturuar, por vetëm nëse ekspozimi kreditor nuk ka pasur trajtim si ekspozim kreditor i ristrukturuar me probleme ose ka kaluar periudhë prej së paku një viti prej se ekspozimi kreditor është larguar nga kategoria e ekspozimit kreditor të ristrukturuar me probleme.

9.3. Në kategorinë e rrezikut "C" klasifikohet:

- ekspozimi kreditor ndaj klientit / projektit të cilit të ardhurat monetare janë të papërshtatshme për shlyerje të rregullt të detyrimeve;

- ekspozimi kreditor ndaj klientit / projektit me afat strukturor të papërshtatshëm të financimit dhe të ardhurave të tij;

- ekspozimi kreditor ndaj klientit ekspozimi i së cilit është i lartë në krahasim me kapitalin dhe/ose klientin i cili ka borxh të konsiderueshëm ndaj kreditorëve;

- ekspozimi kreditor ndaj klientit / projektit për të cilin banka nuk disponon me informacionet e nevojshme dhe të përditësuara për vlerësim të aftësisë kreditore të klientit, ose cilësisë së projektit;

- ekspozimi kreditor me ditë aktuale të vonesës të cilat nuk tej kalojnë 120 ditë;

- ekspozimi kreditor detyrimet e së cilit në periudhën e kaluar prej gjashtë muajve realizohen me vonesë e cila nuk tejkalon 120 ditë ose me përjashtim deri 180 ditë, nëse vonesa është më së shumë dy herë në intervalin prej 121 deri 180 ditë;

- ekspozimi kreditor ndaj klientit person jofinanciar i cili ka kërkesa në bazë të kredisë financiare nga personi me rejting kreditor të njëjtë ose më të ulët se CCC+ (në pajtim me rejtingun e "Standard and Poor's" ose "Fitch") ose Caa1 (në pajtim me rejtingun e "Mudis");

- ekspozimi kreditor ndaj klientit person jofinanciar i cili ka kërkesa në bazë të kredisë financiare nga personi me rejting kreditor më të lartë nga rejtingu i nënparagrafit 7 të kësaj nënpike, por me seli në vend ku rejtingu kreditor është i barabartë ose më i ulët nga CCC+ (në pajtim me rejtingun e "Standard and Poor's" ose "Fitch") ose Caa1 (në pajtim me rejtingun e "Moody's");

- ekspozimi kreditor ndaj klientit person jofinanciar i cili ka kërkesa në bazë të kredisë financiare nga personi për të cilin nuk është përcaktuar rejting kreditor, por është me seli në vend rejtingu kreditor i së cilës është i barabartë ose më i ulët nga B- (në pajtim me rejtingun e "Standard and Poor's" ose "Fitch") ose B3 (në pajtim me rejtingun e "Moody's") ose është me seli në vend për të cilin nuk është përcaktuar rejting kreditor.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj nënpike, banka mund mos ta klasifikojë ekspozimin kreditor ndaj klientit sipas paragrafit 1, nënparagrafë 7, 8 dhe 9 të kësaj nënpike në kategorinë e rrezikut "B", nëse:

- ekspozimi kreditor është në bazë të garancisë doganore ose garancisë së pjesëmarrjes në tender;

- kredia financiare është më e vogël se 31.000.000 denarë (nëse kredia financiare është miratuar në valutën e huaj, merret parasysh kundërvlera në denarë e kredisë së miratuar);

- kredia financiare është e barabartë me ose më e madhe se 31.000.000 denarë, ndërsa ekspozimi kreditor i bankës është më i madh se shuma e kredisë financiare dhe banka ka përcaktuar humbje të pritshme kreditore, së paku në shumën mbi 20% të shumës së kredisë financiare, ku ekspozimi kreditor ose klienti i plotëson kushtet e klasifikimit në kategori tjetër të rrezikut.

9.4. Në kategorinë e rrezikut "Ç" klasifikohet:

- ekspozimi kreditor ndaj klientit i cili është jolikuid;
- ekspozimi kreditor i ristrukturuar me probleme për të cilën klienti vonohet më shumë se 90 ditë ose për të cilën është miratuar ristrukturim i ri;
- ekspozimi kreditor me ditë aktuale të vonesës të cilat nuk tejkalojnë 240 ditë;
- ekspozimi kreditor detyrimet e së cilit në periudhën e kaluar prej gjashtë muajve realizohen me vonesë e cila nuk tejkalon 240 ditë ose me përjashtim deri në 300 ditë, nëse vonesa është më së shumë dy herë në intervalin prej 241 deri 300 ditë;
- ekspozim kreditor ndaj klientit (përfshirë edhe qeveritë dhe bankat qendrore) me rejting kreditor të barabartë ose më të ulët nga CCC+ (në pajtim me rejtingun e "Standard and Poor's" ose "Fitch") ose Caa1 (në pajtim me rejtingun e "Moody's");
- ekspozim kreditor ndaj klientit me rejting kreditor më të lartë nga rejtingu i nënparagrafit 5 të kësaj nënpike, por është me seli në vend ku rejtingu kreditor është i barabartë ose më i ulët nga CCC+ (në pajtim me rejtingun e "Standard and Poor's" ose "Fitch") ose Caa1 (në pajtim me rejtingun e "Moody's");
- ekspozimi kreditor ndaj klientit i cili nuk ka rejting kreditor, por është me seli në vend ku rejtingu kreditor është i barabartë ose më i ulët nga B- (në pajtim me rejtingun e "Standard and Poor's" ose "Fitch") ose B3 (në pajtim me rejtingun e "Moody's") ose është në vend me seli ku nuk është përcaktuar rejting kreditor.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj nënpike, banka mund që mos ta klasifikojë ekspozimin kreditor sipas paragrafit 1, nënparagrafët 5, 6 dhe 7 të kësaj nënpike të kategorisë së rrezikut "Ç", nëse bëhet fjalë për ekspozim kreditor jashtë bilancit në bazë të garancisë doganore ose garancisë së pjesëmarrjes në tender ose nëse bëhet fjalë për ekspozim kreditor ndaj bankës tjetër, në bazë të llogarive aktuale në valutë të huaj.

9.5. Në kategorinë e rrezikut "D" klasifikohen:

- detyrimet e ekspozimit kreditor të cilat realizohen me vonesë e cila nuk i plotëson kushtet e klasifikimit në kategorinë e rrezikut "Ç", në pajtim me nënikën 9.4 të kësaj pike;
- ekspozimi kreditor ndaj klientit mbi të cilin është nisur procedurë falimentimi, përveç në rastet kur për klientin është miratuar plan riorganizimi në pajtim me ligj;
- ekspozimi kreditor ndaj klientit i cili e kundërshton ekzistencën e ekspozimit kreditor (në procedurë gjyqësore ose jashtë saj).

10. Kriteret e klasifikimit të disa kategorive të rrezikut të përcaktuara në pikën 9 të këtij vendimi paraqesin minimumin e kriterëve të cilat banka është e detyruar t'i zbatojë gjatë përcaktimit të kategorisë së rrezikut të çdo ekspozimi kreditor.

Në politikë ose në aktet e tjera të brendshme të pikës 78, nënplikës 78.6 të këtij vendimi, banka mund të përcaktojë edhe kriteret tjera të klasifikimit të ekspozimeve kreditore të kategorive përkatëse të rrezikut, ndryshimi i së cilës nuk mund të shkaktojë

riklasifikim të ekspozimit kreditor në kategori më të mirë të rrezikut nga ajo që është e klasifikuar, në pajtim me kriteret e përcaktuara në pikën 9 të këtij vendimi.

11. Ekspozimi kreditor me probleme nuk mund të klasifikohet në kategoritë e rrezikut "A" dhe "B".

12. Ekspozimi kreditor i cili i plotëson kriteret e klasifikimit në dy ose më shumë kategori të rrezikut klasifikohet në kategorinë më të keqe të rrezikut, e përcaktuar në pajtim me këtë kapitull.

III. PËRCAKTIMI I PËRMIRËSIMIT TË VLERËS DHE TË REZERVËS SË POSAÇME

Kërkesa të përgjithshme

13. Banka përcakton përmirësim të vlerës dhe rezervës së posaçme të ekspozimeve kreditore në bazë të humbjes së përcaktuar të pritshme kreditore në bazë individuale dhe/ose në bazë grupore, më së paku në bazë mujore.

Banka përcakton humbje të pritshme kreditore në bazë individuale më së paku për:

- ekspozimet kreditore me probleme;
- ekspozimet kreditore të ristrukturuara;
- ekspozimet kreditore në bazë të financimit të projekteve;
- ekspozimet kreditore të cilat nuk mund të grupohen në portofol të kredive ose për të cilat banka nuk disponon me të dhëna që të mund t'i përcaktojë normat e probabilitetit për mospagesë dhe normat e humbjes shkakut i mospagesës, si bazë të përcaktimit të humbjes së pritshme kreditore në bazë grupore;
- ekspozimet kreditore të konsiderueshme.

Për nevojat sipas paragrafit 2, nënparagrafi 5 të kësaj pike, banka përcakton humbje të pritshme kreditore në bazë individuale për ekspozimet kreditore të cilat nuk janë përcaktuar si ekspozime të konsiderueshme kreditore në momentin e miratimit të tyre.

Me përjashtim të paragrafit 2, nënparagrafi 1 të kësaj pike, banka mund të përcaktojë humbje të pritshme kreditore në bazë grupore për shumat e pakonsiderueshme të ekspozimeve kreditore me probleme.

14. Shuma e përmirësimit të realizuar të vlerës, pra të shumës së ndarë të rezervës së posaçme për çdo kategori të rrezikut lëvizë në kornizat e këtyre kufijve:

- nga 0,01% deri 5% për kategorinë e rrezikut "A";
- mbi 5% deri 20% për kategorinë e rrezikut "B";
- mbi 20% deri 45% për kategorinë e rrezikut "C";
- mbi 45% deri 70% për kategorinë e rrezikut "Ç";- mbi 70% deri 100% për kategorinë e rrezikut "D".

Shuma e përmirësimit të vlerës, pra shumës së ndarë të rezervës së posaçme për ekspozimin kreditor nuk mund të jetë më e ulët se kufiri i poshtëm i paraparë në paragrafin 1 të kësaj pike për çdo kategori të rrezikut.

15. Me përjashtim të pikës 14, paragrafi 1 të këtij vendimi, banka mund që të mos përcaktojë përmirësim të vlerës, pra të mos ndajë rezervë të posaçme për ekspozimet kreditore të pikës 9, nënparagrafët 1 dhe 6 të këtij vendimi.

16. Për ekspozimet kreditore me probleme të klasifikuara në kategorinë e rrezikut "C", banka duhet të përcaktojë përmirësim të vlerës, pra të ndajë rezervë të posaçme prej së paku 30% të shumës së ekspozimit kreditor.

17. Banka kryen përmirësim të vlerës, pra ndan rezervë të posaçme në shumë prej 100%, për ekspozim kreditor e cila plotëson së paku një prej këtyre kritereve:

- ekzistojnë pritshmëri të forta se banka nuk do të jetë në mundësi të paguaj asnjë pjesë nga ekspozimi kreditor;
- detyrimet në bazë të ekspozimit kreditor realizohen me vonesë më të gjatë se 365 ditë dhe njëkohësisht banka nuk njih instrument kolateral;
- detyrimet në bazë të ekspozimit kreditor realizohen me vonesë më të gjatë se dy vjet dhe njëkohësisht banka nuk njih instrument kolateral.

18. Banka është e obliguar të bëjë përmirësim të plotë të vlerës së interesit të llogaritur në datën kur kërkesat në bazë të interesit kanë marrë trajtim të ekspozimit kreditor me probleme.

Përcaktimi i humbjes së pritur kreditore në bazë individuale

19. Banka e përcakton humbjen e pritur kreditore në bazë individuale për çdo ekspozim kreditor nëpërmjet përcaktimit të vlerës aktuale të rrjedhave të pritura monetare të cilat do të ndodhin në bazë të atij ekspozimi kreditor.

Gjatë përcaktimit të rrjedhave të pritura monetare, banka përfshin të dhëna për ndryshimet e pritura të aftësisë kreditore të klientit, pra të cilësisë së projektit, ku banka mund të përfshijë edhe ndikimin e treguesve makroekonomik dhe të tjerë.

Nëse banka përcakton shumë më të lartë të përmirësimit të vlerës, pra shumë më të lartë të rezervës së posaçme nga shumë e përshkruar në pikën 14, paragrafi 1 të këtij vendimi të kategorisë së rrezikut në të cilën është klasifikuar ekspozimi kreditor, ajo është e detyruar të bëjë riklasifikim të ekspozimit kreditor në kategorinë përkatëse të rrezikut e cila i përshtatet shumës së përcaktuar të përmirësimit të vlerës, pra shumës së rezervës së posaçme.

20. Vlera aktuale e pozitive të bilancit, gjatë përcaktimit të humbjes së pritur kreditore në bazë individuale, fitohet me zbritjen e rrjedhave të pritura monetare në bazë atyre kërkesave me përdorimin e normës efektive të interesit e përcaktuar në pajtim me Rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e evidentimit dhe vlerësimit të normave të kontabilitetit dhe për përgatitje të raporteve financiare.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike pas klasifikimit të kryer të ekspozimit kreditor i cili përbëhet vetëm nga interesi dhe/ose vetëm nga provizionet dhe tarifat, banka nuk është e obliguar të përcaktojë vlerë aktuale të rrjedhave të pritura monetare, ndërsa shumën e përmirësimit të vlerës e përcakton në pajtim me pikën 14 të këtij vendimi.

21. Vlera aktuale e pozitive jashtë bilancit, gjatë përcaktimit të humbjes së pritur kreditore në bazë individuale, fitohet me zbritjen e rrjedhave të pritura monetare si rezultat i pagesave të bankës në bazë të detyrimeve të ndërmarra të mundshme dhe të pagesave nga klienti, me rendimentin aktual të tregut të letrave me vlerë me rrezik të ulët të emetuara në valutë të njëjtë dhe me afat të njëjtë të maturimit si valuta edhe afati i pagesës së pritur.

Vlera aktuale e pozitive jashtë bilancit të paragrafit 1 të kësaj pike, përcaktohet vetëm në rast të rrjedhave të pritura monetare në bazë të detyrimeve të ndërmarra të mundshme.

Nëse nuk ekziston rendimet aktual i tregut të letrave me vlerë me rrezik të ulët me afat të njëjtë të maturimit si afati i pagesës së pritur, përcaktimi i vlerës aktuale të rrjedhave të pritura monetare në bazë të detyrimit të mundshëm të ndërmarrë të bankës kryhet me rendimentin aktual të tregut të letrave me vlerë me rrezik të ulët me afatizim më të afërt deri te afatizimi i pagesës së pritur.

22. Me përjashtim të pikës 21 të këtij vendimi, nëse ekspozimi kreditor në bazë të një marrëveshje përfshin pozita të bilancit dhe jashtë bilancit (për shembull: mbitërheqjet e përdorura dhe të papërdorura dhe kreditë në bazë të kartelave kreditore, pjesa e përdorur dhe e papërdorur e kredive kornizë të parevokueshme, provizion të pozitës jashtë bilancit dhe vetë pozitës jashtë bilancit dhe të ngjashme), banka duhet të zbatojë përqindje të njëjtë të përmirësimit të vlerës edhe të rezervës së posaçme për të gjitha pozitat e ekspozimit kreditor.

23. Për ekspozimet kreditore me probleme për të cilat banka pret që t'i paguajë nëpërmjet sigurimit, gjatë përcaktimit të vlerës aktuale të rrjedhave monetare të atyre ekspozimeve kreditore, banka mund ta merr parasysh vlerën e instrumentit të pranuar kolateral, në pajtim me pikën 24 të këtij vendimi.

24. Sigurimi i cili i plotëson kushtet sipas pikës 25 të këtij vendimi, përfshihet në llogaritjen e vlerës aktuale të rrjedhave të pritura monetare të ekspozimeve kreditore me probleme, në shumën që është e barabartë me shumën më të vogël nga vlera e kolateralit të përcaktuar në pajtim me paragrafin 4 të kësaj pike dhe ekspozimi total kreditor i cili është mbuluar me kolateralin, ku zbritja përfshin periudhën deri në datën e pagesës së pritur të ekspozimit kreditor të kolateralit.

Banka mund të merr parasysh kolateralin sipas paragrafit 1 të kësaj pike gjatë përcaktimit të përmirësimit të vlerës vetëm nëse disponon me dokumentacion përkatës nga e cila mund të vërtetojë se për kolateralin ekziston treg në të cilin mundet shpejtë dhe në mënyrë efikase ta shet kolateralin pas çmimit përkatës i cili do të mundësojë pagesë të ekspozimit kreditor.

Shuma sipas paragrafit 1 të kësaj pike i përfshin edhe shpenzimet e pritura të pagesës nëpërmjet kolateralit të cilat do të mbulohen nga banka.

Vlera e kolateralit nuk mund të jetë më e lartë se:

- 100% nga vlera objektive e instrumentit të klasit të parë kolateral dhe të policave sipas pikës 25, nënparagrafi 25.3. dhe 25.4. të këtij vendimi;
- 100% nga vlera e kërkesave të lëna peng nga qeveria qendrore e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 80% nga vlerësimi i vlerës së tregut në objektin banues të pikës 27, paragrafi 1, nënparagrafi 1 të këtij vendimi;
- 70% nga vlerësimi i vlerës së tregut të objekteve afariste dhe lokaleve afariste sipas pikës 27, paragrafi 1, nënparagrafi 2 të këtij vendimi;
- 60% nga vlerësimi i vlerës së tregut të metaleve të çmuara dhe veprave të artit sipas pikës 27, paragrafi 1, nënparagrafi 10 të këtij vendimi, nëse janë vendosur janë depon e bankës, ose 40% nëse nuk janë deponuar në bankën;
- 60% nga vlerësimi i vlerës së tregut të produktit çmimi i së cilit varet nga lëvizjet e çmimit të atij produkti në bursat botërore të pikës 27, paragrafi 1, nënparagrafi 7 të këtij vendimi;

- 50% nga vlerësimi i vlerës së tregut të objekteve banuese dhe afariste të pandërtuara sipas pikës 27, paragrafi 1, nënparagrafi 8 të këtij vendimi;
- 50% nga vlerësimi i vlerës së tregut të objekteve industriale sipas pikës 27, paragrafi 1, nënparagrafi 3 të këtij vendimi;
- 50% nga vlerësimi i vlerës së tregut të objekteve turistike sipas pikës 27, paragrafi 1, nënparagrafi 5 të këtij vendimi;
- 50% nga vlerësimi i vlerës së tregut të tokës bujqësore sipas pikës 27, paragrafi 1, nënparagrafi 6 të këtij vendimi;
- 40% nga vlerësimi i vlerës së tregut të objekteve bujqësore sipas pikës 27, paragrafi 1, nënparagrafi 4 i këtij vendimi, dhe
- 40% nga vlerësimi i vlerës së tregut të pajisjeve ndërtimore, të prodhimit, bujqësore dhe lloje tjera sipas pikës 27, paragrafi 1, nënparagrafi 9 të këtij vendimi.

Për nevojat e paragrafit 4, nënparagrafëve 3 deri 12 të kësaj pike merret parasysh vlerësimi i vlerës së tregut të kolateralit i përcaktuar në pajtim me pikën 27 të këtij vendimi.

Periudha deri në datën e pagesës së pritur të ekspozimit kreditor me kolateralin sipas pikës 27 të këtij vendimi nuk mund të jetë më i shkurtër se tre vjet nga data e përcaktimit të përmirësimit të vlerës.

Banka duhet të sigurojë dokumentacion të përcaktimit të vlerës së kolateralit.

Instrumente të njohura të kolateralit

25. Si instrument i njohur i kolateralit llogaritet:

- 25.1. Instrumenti i klasit të parë i kolateralit sipas pikës 26) të këtij vendimi.
- 25.2. Garancia e pasurive të patundshme dhe pronës së luajtshme në pajtim me pikën 27) të këtij vendimi.
- 25.3. Polica e sigurimit të kërkesave e lëshuar nga Banka e Zhvillimit të Maqedonisë së Veriut, e vinokuluar në favor të bankës.
- 25.4. Polica e sigurimit jetësor, e cila në pajtueshmëri me rregulloren e Bankës Popullore mbi metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit, ka trajtimin e instrumentit të mbrojtjes së kredisë.
- 25.5. Garancia e kërkesave nga qeveria qendrore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku banka ka dokumentacion të rregullt për garancinë e vendosur, garancia regjistrohet në regjistrin e garancive dhe ka rendin e parë të pagesës në raport me kreditorët e tjerë peng.

Gjatë përcaktimit të kolateralit sipas paragrafit (1), nënpikat 25.1.) dhe 25.5.) të kësaj pike, në qeverinë qendrore përfshihen edhe institucionet publike të cilat, në pajtim me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit, kanë trajtimin si të qeverisë qendrore.

Kolaterali sipas paragrafit (1) të kësaj pike, konsiderohet si instrument i njohur i kolateralit vetëm nëse gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës për ekspozimin kreditor që është e mbuluar nga kolaterali përkatës plotëson kushtet sipas paragrafit (1) të kësaj pike dhe kushtet përkatëse sipas pikës 26) dhe 27) të këtij vendimi.

26. Si instrument kolaterali i klasit të parë konsiderohet kolaterali që plotëson kushtet e mëposhtme:

- 26.1. Depozitë në para në bankë dhe garanci ari në favor të bankës, ku duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:
- afati i pagesës së depozitës në para është i barabartë ose më i gjatë se afati i maturimit të ekspozimit të kredisë të përcaktuar në marrëveshjen e kredisë;
Për nevojat e paragrafit 1 të kësaj pike, banka konsiderohet se është me shumë të zmadhuar të ekspozimeve të kredive me probleme nëse:

- norma e kredive me probleme është e barabartë ose e tejkalon 5%;
- norma e kredive me probleme është nën 5%, por ekziston përqendrim i lartë i ekspozimeve të kredive me probleme (normë e lartë e ekspozimeve të kredive me probleme sipas veprimtarisë, palëve të lidhura, etj.);
- ekzistojnë sinjale për keqësim të cilësisë së portofolit të kredisë (rritje e ndjeshme e vëllimit të ekspozimeve të kredive me probleme, tejkalim i pragjeve të paralajmërimit të hershëm, etj.).

64. Në strategjinë e menaxhimit të ekspozimeve të kredive me probleme, banka përcakton një ose më shumë instrumente për reduktimin e ekspozimeve të kredive me probleme, siç janë:

- ekspozim i ristrukturuar i kredive me probleme dhe mbajtja e tyre në bilancin e bankës;
- shitje, sigurimi ose shlyerje të ekspozimeve të kredive me probleme;
- ndryshimi i llojit të sigurimit, marrja e mjeteve në bazë të kërkesave të papaguara, shndërrimi i ekspozimit të kredisë ose pjesës së saj në investim kapital me klientin, etj.;
- fillimi i procedurës së falimentimit ose procedurës tjetër të pagesës së detyrueshme të ekspozimit të kredive;

Me rastin e përcaktimit të strategjisë për menaxhimin e ekspozimeve të kredive me probleme, banka duhet të:

- vlerësojë kapacitetin për menaxhim dhe reduktim të ekspozimeve të kredive me probleme, ku merren parasysh shtytësit themelorë të rritjes së ekspozimeve të kredive me probleme, duke marrë parasysh specifikat e portofolave të ndryshme, si dhe ndikimet e tyre reciproke, llojin dhe efikasitetin e instrumenteve për reduktimin e ekspozimeve të kredive me probleme në periudhën e mëparshme, burimet e nevojshme njerëzore me përvojë dhe ekspertizë përkatëse për zbatimin e instrumenteve të përzgjedhura, si dhe mbështetjen e nevojshme të TI-së dhe cilësinë e të dhënave që disponon banka për

zbatimin e strategjisë, e cila nuk përjashton mundësinë e përdorimit të shërbimeve nga palë të jashtme;

- vlerësojë karakteristikat e mjedisit aktual dhe të mundshëm të ardhshëm në të cilin punon ose do të punojë banka, duke përfshirë treguesit e lëvizjes së tregut të pasurive të paluajtshme dhe pritshmëritë e tregut për mundësinë e blerjes dhe shitjes së ekspozimeve kreditore me probleme dhe

- vlerësojë ndikimin e strategjisë në funksionimin e bankës, veçanërisht nga aspekti i nivelit të nevojshëm të mjeteve vetanake, profilit të rrezikut, përfitueshmërisë dhe lartësisë së korigjimit të vlerës.

Strategjia është pjesë e procesit të menaxhimit të rrezikut në bankë, veçanërisht në lidhje me procesin e përcaktimit të kapitalit të brendshëm, kuadrit të përgjithshëm për nivelin e pranueshëm të rrezikut, si dhe planin e rikuperimit (gjatë zhvillimit të planit të rikuperimit detyrimisht merren parasysh aktivitetet, treguesit dhe procedurat e përcaktuara në strategjinë).

Banka është e detyruar së paku një herë në vit, ose gjatë ndryshimit të rëndësishëm në sistemin e menaxhimit me rreziqet, të shqyrtojë nevojën e rishikimit të strategjisë dhe nëse është e nevojshme të kryejë rishikim të saj, në pajtim me dokumentin për nivelin e pranueshëm të rrezikut.

65. Shërbimi i auditimit të brendshëm të bankës është i detyruar të kryen auditim të menaxhimit të ekspozimeve të kredive me probleme, në pajtim me planin vjetor të auditimit të brendshëm.

VII. SHLYERJA E EKSPOZIMIT TË KREDIVE

66. Banka kryen shlyerje të ekspozimit të kredisë, në tërësi ose pjesërisht, kur nuk e pret pagesën e saj ose kur nuk ka të drejtë ose të drejtat për pagesën e ekspozimit të kredisë kanë skaduar.

Shlyerja e ekspozimit të kredisë kryhet së paku në rastet në vijim:

- banka nuk ka të drejtë për flukse monetare të ardhshme, gjegjësisht kanë skaduar të drejtat për pagesën e ekspozimit të kredisë, pavarësisht nga baza për shkak të cilës të drejtat janë humbur ose kanë skaduar, që në veçanti përfshijnë: vendim gjyqësor të formës së prerë për pabazueshmërinë e kërkesës së bankës, vendim gjyqësor i formës së prerë për mungesë të së drejtës së kërkesës, aktvendim gjyqësor i formës së prerë për procedurë të mbyllur falimentimi, vendim gjyqësor i formës së prerë për plan të miratuar për riorganizimin e debitorit në falimentim;

- banka nuk ka pritshmëri të arsyeshme për pagesën e ekspozimit të kredisë, tërësisht ose pjesërisht;

- banka ka miratuar vendim për lirimin e borxhit në pajtim me ligjin me të cilin heq dorë nga pagesa e mëtejshme e kërkesës;

- bëhet fjalë për ekspozim kredie individuale të parëndësishme.

Me përjashtim të paragrafit (2) të kësaj pike, banka kryen transferim të detyrueshëm të llogarisë për evidencë jashtë bilancit të ekspozimeve të kredisë të cilët kanë kaluar dymbëdhjetë muaj nga data kur banka është detyruar të kryejë korigjim të vlerës, gjegjësisht të ndajë rezervë të veçantë prej 100%.

Banka është e detyruar, me vendim të Këshillit mbikëqyrës, të konstatojë shumën maksimale të ekspozimit individual të parëndësishëm të kredisë sipas paragrafit (2), nënparagrafi (4) të kësaj pike.

Banka mund të vazhdojë me pagesën e ekspozimit të kredisë sipas paragrafëve (2) dhe (3) të kësaj pike, përveç rasteve kur ajo heq dorë ose nuk ka të drejtë për pagesën e mëtejshme të saj.

67. Banka kryen shlyerje të ekspozimit të kredisë sipas pikës 66), paragrafi (2), nënparagrafi (2) dhe (3) të këtij vendimi, tërësisht ose pjesërisht, me vendim të Këshillit mbikëqyrës të bankës, në bazë të elaboratit për shlyerje të kryer, i cili përmban elementët në vijim:

- arsyeja për shkak të cilës propozohet shlyerja;
- masat e ndërmarra për pagesën e kërkesës dhe rezultatet e këtyre masave;
- personat dhe organet që kanë marrë pjesë në miratimin e kredisë;
- arsyeja e mosekzistimit ose e pamjaftueshmërisë së sigurimit të kërkesës;
- vlerësimi nëse janë respektuar aktet e brendshme të bankës (rregullat, procedurat, etj.) me të cilën përcaktohet miratimi, ndjekja, pagesa dhe shlyerja e ekspozimit të kredisë, dhe
- në rastet kur ekziston lidhje ndërmjet klientit me bankën, shënohen personat në lidhje me bankën, të cilët, në pajtim me Ligjin e Bankave dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij Ligji, konsiderohen të lidhura me klientin.

68. Banka është e detyruar të mbajë evidencë jashtë bilancit për të gjitha ekspozimet e kredisë sipas pikës 66), paragrafët (2) dhe (3) të këtij vendimi për periudhë së paku 10 vjet nga data e shlyerjes së kryer, gjegjësisht nga transferimi i ekspozimit ndaj kredisë ndaj llogarive për evidencë jashtë bilancit.

Me përjashtim të paragrafit (1) të kësaj pike, banka nuk është e detyruar të mbajë evidencë jashtë bilancit për ekspozimet individuale të parëndësishme të kredisë, si dhe në rastet kur banka nuk ka të drejtën e kërimit të caktuar, gjegjësisht kërkon gabimisht shumë të caktuar. Banka duhet të rregullojë procedurën në raste të tilla në aktet e brendshme, me ç'rast e ka parasysh nevojën të disponon me të dhëna përkatëse në bazën e të cilave do të mund të vlerësojë aftësinë kreditore të klientit, të përcaktojë ristrukturimin e ekspozimit të kredive, të vlerësojë pamundësinë e pagesës nga klienti, si dhe për të siguruar përshtatshmërinë e sistemit informativ dhe njoftimin e Bankës Popullore.

VIII. SHITJA E KËRKESAVE TË MATURUARA, ME PROBLEME OSE TË SHLYERA NGA MARRËVESHJA E KREDISË

Procedura dhe rregullat e shitjes së kërkesave të maturuara, me probleme ose të shlyera

69. Banka kryen shitjen e kërkesave të maturuara, me probleme ose të shlyera nga një marrëveshje kredie së bashku me të gjitha të drejtat dytësore që dalin prej tij.

Nën shitjen e kërkesave të maturuara me probleme ose të shlyera nga një marrëveshje kredie nënkuptohet cedimi i plotë ose i pjesshëm i atyre kërkesave nga një

marrëveshje kredie individuale lidhur me persona fizikë dhe juridikë jofinanciar (marrëveshje kredie individuale) ose cedimi i më shumë kërkesave të maturuara, me probleme ose të shlyera nga marrëveshjet e kredisë të lidhura me persona fizikë dhe juridikë jofinanciar (portofoli i marrëveshjeve të kredisë).

Me marrëveshjen e shitjes të kërkesës së maturuar, me probleme ose shlyerje, banka i transferon të drejtat dhe detyrimet, si dhe rreziqet dhe përfitimet nga kërkesa e tij ndaj një pale të tretë, gjë që çon në mosnjohjen e kërkesës në bilancin e bankës, në pajtim me Rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për regjistrimin dhe vlerësimin e zërave të kontabilitetit dhe për përgatitjen e raporteve financiare.

70. Nëse banka kryen shitje të kërkesave të maturuara, me probleme ose të shlyera, në politikën e menaxhimit të rrezikut të kredisë ose në akte të tjera të brendshme për identifikimin, matjen, kontrollin ose reduktimin dhe ndjekjen e rrezikut të kredisë (rregullat, procedurat, etj.) sipas pikës 77) të këtij vendimi rregullon procedurën dhe rregullat për shitjen e atyre kërkesave, të cilat duhet t'i përmbajnë elementët në vijim, sipas llojeve të shitjeve që i kryen banka (shitja e kërkesave nga një marrëveshje të kredisë individuale ose shitje të një portofoli marrëveshje të kredisë):

- llojet e kredive që mund të mbulohen gjatë shitjes së kërkesave;
- mënyra e përcaktimit të kredive në portofolin e marrëveshjeve të kredisë, të cilat do të ishin objekt i shitjes;
- mënyra e përcaktimit të çmimit të shitjes së kërkesave (në lartësinë e kërkesave ose me zbritje);
- metodën e shitjes që banka do të zbaton gjatë shitjes së kërkesave (p.sh. shitje direkte/ të drejtpërdrejta, sistemi i ankandit, sigurimi);
- kriteret për përcaktimin e blerësve potencial të kërkesave;
- përgatitje të draft dokumenteve për lidhjen e shitjes (p.sh. projekt marrëveshje, memorandume për mbrojtjen e besueshmërisë së të dhënave që janë objekt bisedimesh, pëlqimet me shkrim, etj.);
- mënyra e sigurimit të pëlqimit nga klientët e bankës për transferimin e të dhënave për qëllime të shitjes së kërkesave;
- kriteret për përcaktimin e ofruesve të jashtëm të shërbimeve që mund të përfshihen në procesin e bisedimeve dhe strukturimit të shitjes dhe të akteve ligjore për shitjen e kërkesave nga marrëveshja e kredisë.

Marrëveshje për shitjen e kërkesave të maturuara, me probleme ose të shlyera nga marrëveshja e kredisë

71. Para lidhjes së marrëveshjes për shitjen e kërkesave të maturuara, me probleme ose të shlyera, banka është e detyruar të përgatitë vlerësim të efekteve të shitjes së kërkesave dhe të vlerësojë arsyetimin ekonomik të shitjes.

Vlerësimi i efekteve dhe arsyetimi ekonomik i shitjes sipas paragrafit (1) të kësaj pike përfshin së paku vlerësim të efekteve që do të ketë shitja në rezultatin financiar, ekspozimin ndaj rreziqeve, aftësinë paguese dhe likuiditetin e bankës.

72. Përpara lidhjes së marrëveshjes së shitjes, banka është e detyruar personit që synon t'i blejë bankës kërkesë të maturuar, me probleme ose të shlyer nga një

marrëveshje të kredisë t'i sigurojë, të gjitha informatat e nevojshme për vlerësim të duhur të kërkesave, si dhe për vlerësim të normës së mundshme të pagesës.

73. Banka është e detyruar, sipas llojit të shitjes së kërkesës të maturuar, me probleme ose shlyerje, në marrëveshjen e shitjes së kërkesave të sigurojë:

- përkufizim të qartë të të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet bankës dhe blerësit;
- dispozitat mbi pamundësinë e kthimit të rreziqeve dhe përfitimeve të asaj kërkesë;
- dispozitat për rregullimin e menaxhimit dhe pagesën e kërkesave të shitura;
- klauzolë sipas së cilës blerësi i kërkesës do të zbatojë në mënyrë përkatëse rregullat për mbrojtjen e konsumatorëve në pajtim me Ligjin, nëse objekt i shitjes janë kërkesat e konsumatorëve;

- klauzolë sipas së cilës blerësi i kërkesës do të zbatojë në mënyrë përkatëse rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale, në pajtim me rregulloren përkatëse për mbrojtjen e të dhënave personale;

- klauzolë me të cilën ndryshimi i lartësisë së normës së interesit të kërkesës nga marrëveshja e kredisë nuk do të varet ekskluzivisht nga vullneti i blerësit të kërkesës nga marrëveshja e kredisë, duke përfshirë klauzolë me të cilën ndryshimet në kushtet e tjera kontraktuale do t'i referohen vetëm dhënies së kushteve më të favorshme të debitorit, detyrimi i të cilit ndaj bankës është objekt i marrëveshjes së shitjes;

- klauzolë për mbrojtjen nga rreziqet për bankën që mund të dalin nga mosmarrëveshjet e mundshme në lidhje me pagesën e kërkesave të shitura.

Menaxhimi dhe arkëtimi

74. Nëse në bazë të marrëveshjes së lidhur për shitjen e kërkesave të maturuara, me probleme ose të shlyera, banka ka marrë detyrime për menaxhimin dhe arkëtimin e kërkesave të shitura, është e detyruar t'i zbatojë aktet e brendshme dhe praktikat dhe procedurat afariste që i zbaton gjatë pagesës së kërkesave të saj, që në mënyrë përkatëse duhet të parashikohen edhe në marrëveshjen për shitjen e kërkesave.

Nëse, në bazë të marrëveshjes së lidhur të shitjes, blerësi merr përsipër detyrimin e menaxhimit dhe pagesën e kërkesave të shitura të maturuara, me probleme ose të shlyera, marrëveshja e shitjes duhet të përmbajë dispozitë me të cilën blerësi do të detyrohet të respektojë dhe mbrojë integritetin e të gjithë debitorëve dhe nuk do t'i vendosë ata në pozitën më pak të favorshëm se ata e kishin si palë kontraktuale në marrëveshjen e kredisë të lidhur me bankën.

IX. MENAXHIMI I RREZIKUT TË KREDISË

Kërkesa të përgjithshme

75. Menaxhimi i rrezikut të kredisë është pjesë e sistemit të përgjithshëm të bankës për menaxhimin e rrezikut dhe i plotëson kërkesat për menaxhimin e rrezikut të përcaktuara me Ligjin e Bankave, Rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut, si dhe akte të tjera nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji.

76. Nga aspekti i menaxhimit të rrezikut të kredisë, struktura organizative e bankës duhet të mundësojë:

- kompetenca të përcaktuara dhe linja të përgjegjësisë, veçanërisht në procesin e vendimmarrjes për miratimin e ekspozimeve kreditore, për ndryshimin e kushteve kontraktuale, për ristrukturimin e ekspozimeve të kredive, për përdorimin e kolateralit, për përcaktimin dhe zbatimin e strategjisë për menaxhimin e ekspozimeve të kredisë me probleme etj.;

- bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave gjatë menaxhimit të rrezikut të kredisë;

- përkufizim të kompetencave dhe përgjegjësi ndërmjet personave dhe njësive organizative të bankës që janë bartës të aktivitetit të kredisë dhe që kryejnë aktivitete në lidhje me marrjen e rrezikut të kredisë, nga njëra anë, dhe personave dhe njësive organizative që kryejnë aktivitete në lidhje me menaxhimin e rrezikut të kredisë dhe punën në sfond në lidhje me kreditimin, nga ana tjetër.

77. Banka është e detyruar të vendosë dhe zbatojë politikë të menaxhimit të rrezikut të kredisë dhe/ose akte të tjera të brendshme për identifikimin, matjen, kontrollin ose zvogëlimin dhe ndjekjen e rrezikut të kredisë (rregullat, procedurat, etj.), të cilat së paku përmbajnë dispozita për:

77.1. Miratimi dhe klasifikimi i ekspozimeve të kredisë, duke marrë parasysh pikat 78), 79), 80) dhe 81) të këtij vendimi.

77.2. Mënyra e përcaktimit të korigjimit të vlerës / rezervës së veçantë, duke përfshirë mënyrën e përfshirjes së vlerës së sigurimit gjatë përcaktimit të korigjimit të vlerës, duke marrë parasysh pikat 82 dhe 83 të këtij vendimi.

77.3. Mënyra e kryerjes së testimit të stresit të ekspozimit ndaj kredisë, supozimet mbi të cilat bazohet ai testim dhe mënyra e njoftimit në lidhje me rezultatet e testimit.

77.4. Mënyra e menaxhimit të ekspozimeve të kredive të ristrukturuara duke marrë parasysh dispozitat e kreut V të këtij vendimi.

77.5. Mënyra e menaxhimit të ekspozimeve kreditore me probleme, duke marrë parasysh dispozitat e kreut VI të këtij vendimi.

77.6. Mënyra e kryerjes së shlyerjes së ekspozimit të kredisë, gjegjësisht transferimi i ekspozimit të kredisë në evidencën jashtë bilancit, duke përfshirë edhe kriteret, procedurën, organet përgjegjëse për bartjen e vendimit, dokumentacionin në bazë të të cilit është bart vendimi, mënyrën e vendosjes për shlyerjen e plotë ose të pjesshme të ekspozimeve të kredisë, si dhe mënyrën e evidentimit të çregjistrimeve, përkatësisht të transferuara në regjistrat jashtë bilancit, duke marrë parasysh dispozitat e kreut VII të këtij vendimi.

77.7. Procedura dhe rregullat për blerjen dhe shitjen e kërkesave dhe procedura e vendimmarrjes dhe njësitë organizative/organet/personat përgjegjës për vendimmarrje për blerjen dhe shitjen e kërkesave të maturuara, me probleme ose të shlyera merren parasysh dispozitat e kreut VIII të këtij vendimi.

77.8. Përmbajtja dhe mënyra e menaxhimit të dosjes së kredisë për klientët/projektet e bankës, duke marrë parasysh pikën 84) të këtij vendimi.

77.9. Vëllimi dhe frekuenca e njoftimit të Këshillit mbikëqyrës dhe drejtues të bankës dhe të gjithë personave të tjerë të cilët janë të përfshirë në menaxhimin e rrezikut të kredisë, duke marrë parasysh pikën 85) të këtij vendimi.

77.10. Mënyra e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale për nevojat e vlerësimit të aftësisë kreditore të klientit dhe ndjekja e pagesës së ekspozimeve kreditore të miratuara nga banka, duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit me të cilën rregullohet mbrojtja e të dhënave personale.

77.11. Mënyra në të cilën banka merr parasysh ndikimin e rreziqeve në lidhje me ndryshimet klimatike gjatë menaxhimit të rrezikut të kredisë.

Miratimi dhe klasifikimi i ekspozimit të kredisë

78. Banka është e detyruar në aktet e saj të brendshme të parashikojë aspektet e mëposhtme në lidhje me miratimin dhe klasifikimin e ekspozimeve të kredive:

78.1. Kriteret për miratimin e kredive dhe formave të tjera të ekspozimit të kredive, duke përfshirë kriteret për miratimin e ekspozimeve të kredive për financimin e projekteve.

78.2. Kriteret për përcaktimin e aftësisë kreditore të klientit / cilësisë së projektit, gjegjësisht të ndryshimit të aftësisë kreditore të klientit / cilësisë së projektit, duke marrë parasysh së paku kriteret nga pika 7) e këtij vendimi, si dhe përcaktimin e treguesve financiar që banka do t'i përdorë në vlerësimin e kapacitetit financiar të projektit.

78.3. Rregullat e vendimmarrjes për miratimin e ekspozimit të kredive në rastet kur nuk është dhënë mendimi/pëlqimi i njërive organizative që kryejnë aktivitete në lidhje me menaxhimin e rrezikut të kredisë ose nëse mendimi i njërive organizative që kryejnë aktivitete në lidhje me menaxhimin e rrezikut të kredisë është i ndryshëm nga mendimi i njërive organizative të bankës që janë bartëse të aktivitetit të kredisë dhe që kryejnë aktivitete në lidhje me ndërmarrjen e rrezikut të kredisë.

78.4. Kriteret për përcaktimin e rritjes së rrezikut të kredisë, që mund të dallohen për ekspozime individuale të kredisë ose portofolat e kredisë.

78.5. Kriteret për përcaktimin e ndikimeve të mundshme të personave në lidhje me klientin në aftësinë kreditore të tij, si dhe kriteret për përcaktimin e ndikimeve të mundshme të personave me ekspozim të përbashkët të kredisë.

78.6. Kriteret për klasifikimin e ekspozimeve të kredisë në kategori të veçanta rreziku, duke marrë parasysh dispozitat e pikës 10 të këtij vendimi, si dhe mënyrën e vendimmarrjes në lidhje me klasifikimin e ekspozimeve të kredive.

78.7. Mënyra e përcaktimit të lartësisë dhe lloji i normës së interesit, dhe provizionet tjera dhe tarifat.

78.8. Përcaktimi dhe mbikëqyrja e limiteve të brendshme të ekspozimit të kredive, në pajtim me strukturën e ekspozimit të përgjithshëm të kredive të bankës (për shembull: sipas klientëve individual, llojeve të produkteve të kredisë, veprimtarive, monedhave, etj.).

78.9. Përcaktimi i përjashtimeve të lejuara, procedura e miratimit të tyre dhe përcaktimi i nivelit të pranueshëm të ekspozimit të kredive të miratuara me përjashtime të lejuara për një periudhë të caktuar (për shembull: tremujor).

78.10. Përcaktimi i nivelit të pranueshëm të burimit të pagesës, si dhe monedhës së ekspozimit të kredisë.

78.11. Përcaktimi i nivelit të pranueshëm dhe mbikëqyrja e nivelit të treguesve DSTI dhe TDTI dhe përcaktimi i elementeve të veçanta të këtyre treguesve, duke marrë parasysh dispozitat e Rregullores së Bankës Popullore për instrumentet makroprudenciale për cilësinë e kërkesës për kredi nga personat fizikë.

78.12. Përcaktimi i sigurisë që pranon banka (për lloj produkti të caktuar kredie ose për monedhë të caktuar të ekspozimit të kredisë), si dhe:

- përcaktimi i dokumentacionit të nevojshëm për llojet e veçanta sigurimi nga pika 27) e këtij vendimi;
- përcaktimi i treguesit LTV sipas llojeve të veçanta të sigurimit;
- procedura, rregullat dhe frekuenca e mbikëqyrjes dhe përcaktimit të vlerës së tregut të sigurimit, përfshirë edhe për nevojat e llogaritjes së treguesit LTV;
- procedura dhe afatet për ndërmarrjen dhe/ose shitjen e (sigurimit) kolateralit.

78.13. Metoda e përcaktimit dhe e mbikëqyrjes së rregullsisë në shlyerjen e detyrimeve për nevojat e klasifikimit të ekspozimit të kredisë.

78.14. Vlerësimi i rrezikut të kredisë që del nga rreziku valutor ndaj të cilit është i ekspozuar klienti dhe përcaktimi i kriterëve për miratimin e kredisë në valutë ose në denarë me klauzolë devizore, duke marrë parasysh dispozitat e pikës 81) të këtij vendimi dhe mënyrën e të cilës ky vlerësim merret parasysh gjatë klasifikimit të ekspozimit të kredisë.

78.15. Kriteret për mbikëqyrjen e rrezikut të vendit ku ndodhet selia, gjegjësisht nga vjen klienti, personi i huaj dhe për mbikëqyrjen e rrezikut të ndryshimeve të normave të interesit.

78.16. Vlerësimi i rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit në aspekt të ndikimit që ky rrezik e ka ose do të kishte në mundësinë e klientit për të shlyer detyrimet e tij ndaj bankës, në pajtim me kushtet e dakorduara, duke përfshirë përcaktimin e ndikimit të rrezikut nga ndryshimi i normave të interesit të portofolit të kredisë së bankës, në kuadër të stres-testimit të rregullt të bankave.

79. Banka është e detyruar para miratimit të ekspozimit të kredisë, t'i përcaktojë të gjithë faktorët që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në rrezikshmërinë e ekspozimit të kredisë, gjegjësisht për klientin/projektin, duke marrë parasysh së paku kriteret sipas pikës 7) të këtij vendimi.

80. Nëse banka ka zhvilluar kategori të brendshme rreziku për nevojat e llogaritjes së korigjimit të vlerës, dhe të cilat ndryshojnë nga kategoritë e rrezikut të përcaktuara në pikën 9 të këtij vendimi, banka duhet të mundësojë lidhjen e tyre me kategoritë e rrezikut të parashikuara nga ky vendim si dhe të sigurojë zbatimin konsistent të tyre, si në miratimin e ekspozimit ndaj kredisë ashtu edhe në mbikëqyrjen e tij.

81. Vlerësimi i rrezikut të kredisë që buron nga rreziku valutor ndaj të cilit është i ekspozuar klienti duhet t'i referohet së paku mbikëqyrjes, analizës dhe vlerësimit të (mos)pajtueshmërisë së pozicionit valutor të klientit dhe ndikimit të tij në mundësinë që klienti t'i shlyejë rregullisht detyrimet e tij ndaj bankës.

Përveç kriterëve të përcaktuara në pajtim me pikën 78) të këtij vendimi, gjatë miratimit dhe mbikëqyrjes së kredive në valutë të huaj dhe në denarë me klauzolë valutore është e obliguar të përcaktojë dhe zbatojë kriterë të tjera të përcaktuara në aktet e saj të

brendshme (p.sh. : limite kuantitative të pjesëmarrjes së ekspozimit kreditor në valutë dhe në denarë me klauzolë valutore në ekspozimin kreditor të bankës, limite kuantitative për treguesit DSTI, TDTI dhe treguesin LTV etj.).

Në kuadër të testimit të rregullt të stresit, banka është e detyruar, së paku një herë në vit, të përcaktojë ndikimin e ndryshimeve të kursit të këmbimit në portofolin e kredisë së bankës, nëpërmjet vlerësimit të (mos)pajtueshmërisë së pozicionit valutor të klientit dhe ndikimit të saj në mundësinë e klientit për të shlyer rregullisht detyrimet e tij ndaj bankës.

Nëse të hyrat e pritshme valutore, kërkesat valutore dhe kërkesat në denarë me një klauzolë valutore të klientit mbulojnë së paku 80% të daljeve të përgjithshme të pritshme të tij në valutë, detyrimet valutore dhe në denarë me klauzolë valutore, konsiderohet se ai ka pozicion të harmonizuar valutor. Konsiderohet se eksportuesit neto edhe klientët tek të cilët çmimi i produktit më të përfaqësuar varet nga lëvizjet e çmimeve të atij produkti në bursat botërore gjithashtu kanë pozicion të harmonizuar valutor.

Banka është e detyruar të vendosë regjistër të klientëve me pozicion valutor të harmonizuar dhe të paharmonizuar.

Me përjashtim, banka nuk është e obliguar t'i zbatojë dispozitat e kësaj pike për klientët, ekspozimi i përgjithshëm kreditor i të cilëve është deri në 200.000 denarë për persona fizikë dhe ndërmarrje të vogla, përkatësisht deri në 600.000 denarë për persona të tjerë juridikë.

Me rastin e miratimit të kredive në valutë ose në denarë me klauzolë devizore, banka është e obliguar ta informojë klientin për të gjitha rreziqet që dalin nga përdorimi i këtyre produkteve kreditore, duke përfshirë edhe klientët sipas paragrafit 6 të kësaj pike.

Shërbimi i auditimit të brendshëm të bankës është i detyruar të kryejë auditim të vlerësimit të rrezikut të kredisë që del nga rreziku i monedhës, në pajtueshmëri me planin vjetor të auditimit të brendshëm.

Përcaktimi i korigjimit të vlerës/rezervës së veçantë

82. Banka është e detyruar në aktet e saj të brendshme të parashikojë dispozitat e mëposhtme në lidhje me mënyrën e përcaktimit të korigjimit të vlerës/rezervës së veçantë:

82.1. Përcaktimi i ekspozimeve të kredisë për të cilat konstaton se humbja e pritshme e kredisë në bazë individuale dhe/ose grupore, duke përfshirë edhe mënyrën e përcaktimit të ekspozimit të rëndësishëm të kredisë dhe shumës së parëndësishme për ekspozimet e kredive me probleme.

82.2. Përshkrim i detajuar i mënyrës së llogaritjes së humbjes së pritshme të kredisë në bazë individuale, gjegjësisht, përcaktimi i flukseve monetare të pritshme, supozimet në bazë të së cilës ato bazohen, duke përfshirë treguesit makroekonomikë ose të tjerë që mund të kenë ndikim në flukset monetare të pritshme.

82.3. Kriteret për formimin e portofolit të kredisë dhe përshkrimi i detajuar imodelit për llogaritjen e humbjes së pritshme të kredisë për ekspozimet e kredisë nga portofoli i kredisë, i cili përfshin:

- mënyrën e përcaktimit të normës së probabilitetit të mospagesës dhe normës së humbjes për shkak të mospagesës, duke përfshirë informata për bazën e të dhënave që përdoret gjatë

llogaritjes së normave dhe periudhën kohore të cilës i referohen të dhënat;

- supozimet mbi të cilat bazohet modeli i përcaktimit të normës;

- përcaktimin e treguesve makroekonomikë ose të tjerë që mund të kenë ndikim në llogaritjen e humbjes së pritshme të kredisë për një portofol të përshtatshëm kredie dhe mënyrën e përfshirjes së tyre në model;

- përshkrimin e metodës dhe dinamikës së kryerjes së një vlerësimi të pavarur të realitetit dhe efikasitetit të modelit, përcaktimin e nivelit të pranueshëm e shmangies së rezultateve të vlerësimit dhe përcaktimin e aktiviteteve që do të ndërmerren nga organet e bankës për të harmonizuar modelit me rezultatet e fituara nga vlerësimi i realitetit të tij.

82.4. Mënyra e përfshirjes së vlerës së kolateralit në përcaktimin e vlerës aktuale të flukseve monetare të pritshme, e cila i përfshin:

- procedurën dhe rregullat për përcaktimin e periudhës deri në datën e pritshme të pagesës të ekspozimit të kredisë me kolateralin e pranuar dhe për përcaktimin e përqindjes së uljes së vlerës së kolateralit që përfshihet në përcaktimin e humbjes së pritshme të kredisë për ekspozimet e kredive me probleme,

- procedurën e vlerësimit të nevojës për rishikimin e mënyrës së përcaktimit të vlerës së kolateralit dhe të periudhës deri në datën e pagesës së pritshme të ekspozimit të kredive me kolateralin,

- metodën e mbikëqyrjes së vlerës së tregut të kolateralit (p.sh. nëpërmjet zbatimit të metodave statistikore), duke përfshirë edhe mënyrën e konfirmimit të realitetit të mënyrave që banka i përdor për të mbikëqyrë vlerën e tregut,

- metodën e përcaktimit se ka ndodhur një rënie e ndjeshme në çmimet e tregut të kolateralit të pranuar,

- dokumentacionin mbi bazën e të cilit mund të konfirmohet se ekziston treg për kolateral, në të cilin shpejt dhe me efikasitet do të mund ta shesë kolateralin me çmim të përshtatshëm që do të mundësojë pagesën e ekspozimit të kredisë,

- mënyra e përcaktimit të shpenzimeve të pritshme për pagesën nëpërmjet kolateralit, të cilat do të bien mbi bankën.

82.5. Metoda e përcaktimit të humbjes së pritshme të kredisë për investimet në letrat me vlerë të borxhit që klasifikohen dhe maten me vlerën objektive përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

83. Shërbimi i auditimit të brendshëm të bankës është i detyruar të auditojë përcaktimin e korigjimit të vlerës / rezervës së veçantë, duke përfshirë përshtatshmërinë e mënyrës së përcaktimit dhe mbikëqyrjes së vlerës së tregut të kolateralit, në pajtim me planin vjetor të auditimit të brendshëm.

Dosja e kredisë

84. Banka është e detyruar të mbajë dosje të kredisë për çdo klient/projekt që e financon.

Dosja e kredisë duhet të përmbajë të gjitha të dhënat mbi bazën e të cilave banka do të mund të përcaktojë identitetin, aftësinë kreditore të klientit, cilësinë e projektit, rregullsinë në shlyerjen e detyrimeve dhe cilësinë e kolateralit.

Në dosjen e kredisë së klientit, banka e ruan gjithashtu të gjithë dokumentacionin që lidhet me procesin e vendimmarrjes për miratimin ose ristrukturimin e ekspozimit të kredive, analizat e kryera për nevojat e ristrukturimit ose përcaktimin e pamundësisë së pagesës, analizat e kryera për nevojat e përjashtimit të ekspozimit të kredive nga ristrukturimi i ekspozimit të kredive dhe/ose me probleme, procedurat e pagesës së detyruar, konflikte gjyqësore, etj.

Banka mund të menaxhojë dosjen e kredisë për çdo klient, gjegjësisht projekt në formë elektronike.

Sistemi i njoftimeve

85. Sistemi i njoftimit të bankës duhet të sigurojë të dhëna dhe/ose informata së paku për:

- strukturën e përgjithshme të ekspozimit të kredive, sipas kategorisë së rrezikut dhe sipas aktiviteteve/fushave që janë të rëndësishme për ekspozimin e kredive të bankës (për shembull: sipas sektorëve, produkteve të kredive, monedhës, treguesve TDTI dhe DSTI, lloji i kolateralit, maturimi, vendi dhe të ngjashme);
- ekspozimin e përgjithshëm të kredive të bankës ndaj palëve të lidhura;
- ekspozimet e kredive me probleme, arsyet që kanë ndikimin më të madh në rritjen e ekspozimeve të kredive me probleme, shuma e përgjithshme e ekspozimeve të kredive me probleme të përjashtuara, si dhe arsyet e përjashtimit të tyre;
- lëvizjen e ekspozimeve të kredive nga një kategori rreziku në tjetrën, në periudhë të caktuar kohore në bazë të përgjithshme;
- ekspozimet e kredive të miratuara në bazë të përjashtimeve të përcaktuara në aktet e brendshme të bankës;
- vlerësimin e kryer dhe rezultatet e fituara nga vlerësimi i realitetit të modelit për përcaktimin e humbjes së pritshme të kredisë në bazë grupore;
- rezultatet e testimit të stresit;
- ristrukturimet e ekspozimeve të kredive;
- ekspozimet e kredive të shlyera dhe ekspozimet e kredive të transferuara në evidencë jashtë bilancit sipas pikës 66), paragrafët (2) dhe (3) të këtij vendimi;
- nivelin dhe lëvizjet e humbjes së pritshme të kredisë në nivelin e ekspozimit të përgjithshëm të kredisë dhe sipas aktiviteteve/zonave të veçanta (p.sh.: sektorë, valutë, maturim, etj.);
- ekspozimet e kredive me probleme të paguara, ekspozimet e kredive të shlyera dhe ekspozimet e kredive të paguara që janë transferuar në të dhënat jashtë bilancit (struktura, shuma, norma e pagesës, etj.); - kreditë e gjelbra të miratuara; - kërkesat e shitura.

X. MENAXHIMI I RREZIKUT TË KREDISË NË BAZË TË KONSOLIDUAR

86. Banka e cila është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar është e detyruar ta zbatojë këtë vendim në bazë individuale dhe të konsoliduar, në nivel të grupit bankar.

87. Banka e cila është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar është e detyruar të sigurojë respektimin e dispozitave të këtij vendimi nga të gjithë anëtarët e grupit bankar, veçanërisht në lidhje me sigurimin e aplikimit të vetëm në mënyrën e përcaktimit dhe të përcaktimit të ekspozimeve të ristrukturua të kredive me probleme dhe kushtet për përjashtim nga këto kategori, të përcaktuara në këtë vendim.

Gjatë vlerësimit të pamundësisë së pagesës të detyrimeve ndaj klientit në pajtim me pikën 54) të këtij vendimi, banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar merr parasysh edhe faktin nëse ndonjë anëtare e grupit bankar ka paraqitur propozim për hapjen e një falimentimi apo procedurë tjetër të ngjashme ndaj klientit, në pajtim me Ligjin.

XI. NJOFTIMI I BANKËS POPULLORE

88. Bankat përbëjnë raport për zbatimin e këtij vendimi sipas gjendjes së kontabilitetit në fund të çdo muaji dhe e dorëzojnë deri te Banka Popullore.

Afati i fundit për dorëzimin e raportit është 15 ditë pas përfundimit të periudhës për të cilën njoftohet.

Me përjashtim të paragrafit (2) të kësaj pike, afati për dorëzimin e raportit me gjendje të datës 31 dhjetor është pesë ditë pune pas përfundimit të afatit për dorëzimin e raportit financiar vjetor të pa audituar.

89. Banka është e detyruar ta njoftojë Bankën Popullore edhe për:

- ristrukturimin e ekspozimit të kredive, e cila paraqet ekspozim të madh në pajtim me Ligjin e Bankave;

- ristrukturimin e ekspozimit të kredive me ndryshim të rëndësishëm në kushtet kontraktuale;

- shlyerjen e ekspozimit të kredisë, tërësisht ose pjesërisht, e kryer në pajtim me pikën 66), paragrafin (2), të këtij vendimi,

- transferimin e detyrueshëm të llogarive për evidencën jashtë bilancit të ekspozimeve të kredisë, i kryer në pajtim me pikën 66), paragrafi (3), të këtij vendimi;

- planin operativ të përgatitur për ndërmarrjen e aktiviteteve për reduktimin e ekspozimeve të kredisë me probleme;

- shmangien nga qëllimet e përcaktuara me planin operativ për reduktimin e ekspozimeve të kredive me probleme;

- vlerësimin e kryer dhe rezultatet e fituara nga vlerësimi i realitetit të modelit për përcaktimin e humbjes së pritshme të kredive në bazë grupore;

- shitjen e kërkesave të maturuara, me probleme ose të shlyera;

- kreditë e gjelbra të miratuara, dhe

- pagesën e ekspozimeve të kredive që më parë janë shlyer në pajtim me pikën 66), paragrafët (2) dhe (3) të këtij vendimi.

Afati për dorëzimin e njoftimit sipas paragrafit (1), nënparagrafët (1), (2), (3), (5), (6) dhe (7) të kësaj pike është dhjetë ditë pas: miratimit të vendimit për ekspozimin e

ristrukturar të kredive, miratimit të vendimit për ekspozimin e ristrukturuar të kredive me ndryshim të rëndësishëm të kushteve kontraktuale, miratimit të vendimit për shlyerjen e ekspozimit të kredisë (në tërësi ose pjesërisht), përgatitjes së planit operativ për ndërmarrjen e aktiviteteve për reduktimin e ekspozimeve kreditore me probleme, shmangies nga synimet e përcaktuara nga plani operativ për reduktimin e ekspozimeve të kredisë me probleme dhe vlerësimit i kryer dhe rezultatet e fituara nga vlerësimi i realitetit të modelit për përcaktimin e humbjes së pritshme të kredisë në bazë grupore.

Me përjashtim të paragrafit (2) të kësaj pike, banka është e detyruar të dorëzojë çdo muaj raport për shlyerjet e kryera të ekspozimeve të kredisë individuale të parëndësishme sipas pikës 66), paragrafi (2), nënparagrafi (4) të këtij vendimi në bazë mujore.

Banka është e detyruar të dorëzojë raporte për ekspozimet e kredive të transferuara në llogaritë jashtë bilancit të evidencës sipas paragrafit (1), nënparagrafi (4) të kësaj pike, kërkesat e shitura sipas paragrafit (1), nënparagrafi (8) të kësaj pike, për kreditë e gjelbra të miratuara sipas paragrafit (1), nënparagrafi (9) të kësaj pike dhe për pagesën e ekspozimeve të kredive të shlyera më parë sipas paragrafit (1), nënparagrafi (10) të kësaj pike në bazë mujore.

Raportet nga paragrafët (3) dhe (4) të kësaj pike i dorëzohen Bankës Popullore në pajtim me pikën 88), paragrafët (2) dhe (3) të këtij vendimi.

90. Me kërkesë të veçantë të Bankës Popullore, banka është e detyruar të përgatitë raport me gjendjen në një ditë tjetër dhe në afat tjetër, që janë të ndryshëm nga gjendja dhe afati i përcaktuar në pikat 88) dhe 89) të këtij vendimi.

XII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

91. Guvernatori i Bankës Popullore me udhëzim përshkruan mënyrën dhe procedurën e dorëzimit të raportit për zbatimin e këtij vendimi sipas pikave 88) dhe 89) të këtij vendimi, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularëve.

92. Dispozitat e këtij vendimi që u referohen bankave në mënyrë përkatëse zbatohen edhe ndaj shtëpive të kursimit.

Filialet e bankave të huaja janë të detyruara t'i zbatojnë dispozitat e këtij vendimi, duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit të Bankave dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji, me të cilat rregullohet veprimtaria e filialeve të bankave të huaja në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

93. Banka është e detyruar të përgatitë raportin e parë sipas pikës 88), paragrafi (1) të këtij vendimi, me efekt të përcaktuar të zbatimit të përkufizimit të ri të ekspozimeve të kredisë me probleme të ekspozimeve të kredisë, me gjendje të datës 31 janar 2024 dhe ta dorëzojë deri te Banka Popullore më së voni deri në afatin e përcaktuar në pikën 88), paragrafi (2) të këtij vendimi. Banka është e detyruar të zbatojë përkufizimin e ri për ekspozimet e kredisë me probleme të klientëve/ekspozimet e kredisë me gjendje të datës 1 janar 2024, shuma e maturuar e të cilëve është mbi pragun e rëndësisë gjatë gjithë periudhës prej më datë 1 tetor 2023 deri më 1 janar 2024.

94. Në ditën e fillimit të zbatimit të këtij vendimi, pushon vlefshmëria e Vendimit për metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të kredisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 149/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 76/20, 116/20 dhe 83/22).

95. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 janari i vitit 2024.

Me përjashtim të paragrafit (1) të kësaj pike, dispozitat e pikës 77), nënpika 77.11.) të këtij vendimi do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari i vitit 2025.

Nr. 02-6835/6
27 shkurt 2023
Shkup

Zëvendësguvernatorja
dhe Kryesuesja e Këshillit të
Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut,
Mr. **Ana Mitreska**, d.v.